

RAPORTI I TRANSPARENCËS

**për vitin ushtrimor
të mbyllur më 31.12.2022**

Përmbajtja

Hyrje	3
Shoqëria dhe struktura e qeverisjes	5
Kontrolli i cilësisë dhe trajnimi profesional	7
Pavarësia dhe etika	10
Informacione të tjera shpjeguese	12
Shtojca	13
Lista e Subjekteve me Interes Publik	13
Informacione Financiare	14
Kontakt	15



Hyrje

Ju paraqesim Raportin tonë të Transparencës, për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 i cili përmban informacion në përputhje me nenin 45 të ligjit, nr. 10091/ 2009 ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor & të Kontabilistit të Miratuar”.

Pajtueshmëria me këtë kërkesë na lejon të komunikojmë çdo vit me palët e treta mbi rrugën e ndjekur deri më tani dhe në të njëjtën kohë na jep mundësinë për të riafirmuar objektivat që synojmë në kryerjen e punës sonë profesionale.

Ne gjithmonë i rezervojmë vendin e parë transparencës në shkallën e vlerave të cilave i referohemi, duke e konsideruar atë një kërkesë themelore, një garanci të nënkuptuar dhe një burim të nxjerrjes së të gjitha parimeve të tjera etiko-morale, dhe për këtë arsye të domosdoshme për ndërtimin e asaj marrëdhënieje besimi që duhet të vendoset midis aktorëve të ndryshëm që veprojnë në treg.

Përgatitja dhe publikimi vjetor i këtij raporti të transparencës na jep një mundësi më të gjerë për të informuar më hollësisht kompanitë dhe tregun, mbi parimet etiko-profesionale, mbi veprimtaritë e qeverisjes dhe mbi procedurat e kontrollit të cilësisë së punës që drejtojnë punën tonë profesionale.

Objektivi, të cilin ne ndajmë me ligjvënësin, është që të përpiqemi t'u transmetojmë përdoruesve të punës sonë, një mjet që lejon një transparencë më të gjerë mbi zgjedhjet e bëra dhe politikat e ndjekuara brenda shoqërisë sonë për të arritur një standard të lartë profesional.

Të gjitha këto zgjedhje dhe politika, të koordinuara dhe të qeverisura nga procedurat e kontrollit të cilësisë së punës na lejojnë të vendosim shkallën e lartë të profesionalizmit në kryerjen e detyrave tona si dhe të rinovojmë angazhimin tonë për të drejtuar sa më mirë burimet në dispozicion dhe për të përsosur aftësitë teknike për të cilat tregu ka nevojë për një vlerësim objektiv dhe transparent të transaksioneve të tij.

Shoqëria dhe struktura e qeverisjes

Public Accounting Service Union and Trust (PASUT shpk) është një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e cila ka si qëllim të saj auditimin dhe organizimin e kontabilitetit të shoqërive, si dhe ofrimin e të gjitha atyre shërbimeve të ofruara nga legjislacioni aktual.


PASUT shpk është regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Biznesit me nipt L21423032S dhe në regjistrin publik të ekspertëve kontabël të autorizuar pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) më 08.11.2011 me numër license 231. Partner auditimi i PASUT shpk është Ilda Duhaxhiu. Shoqëria ka seli ligjore në Rrugën: Themistokli Gërmenji, Pallati: Ambasador 1, Kati I, Tiranë.



Struktura operative e shoqërisë

Numri mesatar i personelit të PASUT shpk gjatë këtij viti ishte 12 punonjës, ndërsa struktura e ortakëve përbëhet nga ortaku i vetëm. Administratorë të shoqërisë me mandat 5 vjecar janë:

Znj. Ilda Duhaxhiu & Znj. Evis Duhaxhiu.



Kontrolli i cilësisë dhe trajnimi profesional

Sistemi i kontrollit të cilësisë të miratuar nga Public Accounting Service Union and Trust, ilustruar në detaje në manualin "Procedurave të kontrollit të cilësisë për audituesin ligjor" dhe i rregulluar nga direktivat specifike dhe procedurat e aplikimit të parashikuara në të, vepron në thelb përmes:

- funksionit të Drejtimit i cili ka për detyrë, si dhe të mbështesë teknikisht përgjegjësit e detyrave dhe ekipeve të punës, gjithashtu për të siguruar që standardi i profesionalizmit të jetë njëtrajtësisht i lartë në të gjitha detyrat e marra;
- funksionit të Kontrollit të Cilësisë, të cilit i është besuar përgjegjësia e menaxhimit dhe zgjidhjes së problemeve në lidhje me kërkesat profesionale, përfshirë pavarësinë e audituesit, kompetencën dhe profesionalizmin, përmes metodave të komunikimit të kërkuara nga struktura dhe kontrole të rregullta të zbatimit të direktivave dhe procedurave të parashikuara.

Direktivat dhe procedurat e paraqitura për këtë qëllim i referohen shoqërisë në tërësi dhe secilës detyrë të kryer.

Më hollësisht, sistemi i kontrollit të cilësisë synon të ndjekë objektivat e mëposhtëm:

- aktiviteti i auditimit kryhet në përputhje të plotë me parimet e pavarësisë, objektivitetit, konfidencialitetit dhe profesionalizmit;
- personeli duhet të ketë një nivel të lartë të përgatitjes dhe kompetencës;
- aktivitetet e drejtimit, mbikëqyrjes dhe rishikimit që synojnë të sigurojnë pajtueshmërinë me nivelet e kërkuara të cilësisë kryhen menjëherë;
- stafi profesional i drejtohet, në rastet e nevojshme, për konsultim personave të brendshëm ose të jashtëm me aftësi dhe përvojë të lartë;
- shoqëria miraton procedura të përshtatshme, si në fazën e marrjes klientit por edhe më pas, për vlerësimin e ekzistencës së kërkesave profesionale, etike dhe pavarësisë, si dhe të aftësisë së strukturës së saj profesionale për të siguruar një shërbim të përshtatshëm;
- shoqëria monitoron vazhdimisht përshtatshmërinë dhe efektivitetin e funksionimit të sistemit të saj të kontrollit të cilësisë.

PASUT shpk investon në programe trajnimi, që përfshijnë kurse të brendshme dhe të jashtme, nga kursi bazë për punësimet e reja, në kurset e niveleve më të avancuara. Kurset e trajnimit strukturohen në mënyrë të tillë që të garantojnë një numër minimal të orëve të trajnimit në secilin nivel profesional gjatë vitit.

Programi i trajnimit gjithashtu merr parasysh detyrimin e trajnimit të vazhdueshëm për ata që janë regjistruar në Regjistrin e Audituesve Ligjorë.

Zhvillimi profesional në punë gjithashtu i nënshtrohet vlerësimit dhe monitorimit të rregullt.

Vlerësimi i performancës kryhet në fund të çdo pune të rëndësishme. Procesi i vlerësimit, siguron bazën për politikat e avancimit profesional dhe politikat e shpërblimit dhe stimulimit.

Public Accounting Service Union and Trust i nënshtrohet kontrollit të cilësisë nga Bordi i Mbikeqyrjes Publike në përputhje me Ligjin nr. 10091/ 2009 ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor & të Kontabilistit të Miratuar”.

Pavarësia dhe etika

PASUT shpk është e përkushtuar për të promovuar cilësinë në shërbimet e saj të auditimit dhe ka prezantuar një kulturë të shoqërisë që favorizon standardet më të mira të cilësisë së përgatitjes, kompetencës dhe etikës profesionale.

Kjo qasje reflektohet në grupin e direktivave dhe procedurave që përbëjnë Manualin e Kontrollit të Cilësisë (QCM) dhe Kodin e Etikës Profesionale të Sjelljes, të cilat përfshihen në bazën e të dhënave të menaxhimit për përdorimin aktual nga personeli. Për pranimin e angazhimeve, personeli duhet të konstatojë nëse angazhimi është në pajtim me kërkesat rregullatore dhe profesionale të pavarësisë.

Public Accounting Service Union and Trust i kërkon stafit të saj një deklaratë specifike të nënshkruar, gjatë fazës së rekrutimit dhe më pas në bazë vjetore, në të cilën ata konfirmojnë pajtueshmërinë me të gjitha përshkrimet e parashikuara nga legjislacioni dhe nga parimet e auditimit për pavarësinë.

Kjo deklaratë ripërtërihet për çdo detyrë individuale nga secili anëtar i ekipit të auditimit të caktuar për të.

Siç kërkohet nga kuadri rregullator Public Accounting Service Union and Trust për pranimin e angazhimeve, për shërbime të tjera përveç auditimit ose për krijimin e marrëdhënieve të tjera të biznesit, të gjithë anëtarët duhet të konstatojnë nëse shërbime të tilla ose marrëdhënie të tjera janë në përputhje me kërkesat rregullatore dhe profesionale të pavarësisë.

Kërkesat etike në procesin e punës të realizuar nga PASUT shpk janë në përputhje me kërkesat e IEKA dhe udhëzimet e përcaktuara në Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët, të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC).

PASUT shpk u mundëson punonjësve të konsultohen dhe raportojnë çështje dhe situata etike, si dhe nxit angazhimin e tyre përmes programeve të trajnimit me profesionistë të fushës për të ofruar një siguri të arsyeshme që aktiviteti operativ i tyre përputhet me kërkesat përkatëse etike.

Informacione të tjera shpjeguese

Administratorët janë përgjegjës për qeverisjen dhe mbikëqyrjen e praktikës së Auditimit dhe Sigurisë.

Përgjegjësitë specifike përfshijnë aprovimin e strategjisë lokale të biznesit për auditimin dhe sigurinë, aprovimin e aspekteve financiare të planeve të biznesit etj.

Administratorët kanë kompetencat më të gjera për të menaxhuar aktivitetet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme, të nevojshme për zbatimin e qëllimit të shoqërisë, pa paragjykuar çështjet që me ligj dhe Statutin e Shoqërisë i janë deleguar në mbledhjen e ortakut të vetëm.

Administratorët hartojnë rregulloret e brendshme profesionale që rregullojnë edhe shërbimet ndihmëse.

Përfaqësimi ligjor i shoqërisë realizohet nga ortaku i vetëm znj. Ilda Duhaxhiu.

Shoqëria ka një ortak të vetëm i cili është partneri i angazhimit dhe shpërblimi i ortakut parashikohet në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Shtojca

▪ Lista e Subjekteve me Interes Publik*

EMRI I SUBJEKTIT	FORMA LIGJORE
AGJENSIA E TRAJTIMIT TE KREDIVE	Ent Publik
OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE GROUP	SHA
POSTA SHQIPTARE SH.A	SHA
CENTER SHQIPTARE	SHA
FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË	SHA


* Sipas përcaktimit të ligjit nr. 10091/2009 i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 17/2019, për klasifikimin e njësive me "interes publik" për sa i përket natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të të punësuarve.

■ Informacione Financiare


Kapitali i shoqërisë PASUT shpk është i barabartë me 100'000 Lekë, i paguar plotësisht dhe përfaqësohet nga 100 kuota me vlerë nominale të barabartë me 1'000 lekë të zotëruara nga ortaku i vetëm.

Të ardhurat e shoqërisë për vitin e mbyllur më 31.12.2022 paraqiten si mëposhtë:

ZËRI I TË ARDHURAVE	SHUMA NË LEKË
Auditimi Ligjor (EIP ose filiale të EIP)	5'763'000
Auditimi Ligjor (jo-EIP ose filiale të jo-EIP)	1'610'033
Shërbime jo-auditimi (entitete të tjera)	35'409'926
Totali	42'782'959



- **Kontakt**



ilda.duhanxhiu@pas-ut.com